

RREGULLORE E EDUKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË VIJUESHËM PROFESIONAL

Në zbatim të Ligjit Nr. 10091 datë 5.3.2009 "Për Auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të miratuar"(i ndryshuar me ligjin 47/2016), të Statutit të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Rregjistruar dhe të kërkesave që burojnë nga deklaratat e detyrimeve të anëtarësisë të IEKAs në IFAC, bazuar edhe në eksperiencën e deritanishme dhe në përvojën më të mirë ndërkombëtare, Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve të IEKA-s, miraton këtë rregullore për edukimin e kandidatëve dhe zhvillimin e vijueshëm profesional të anëtarëve.

Seksioni 1

I. Të përgjithshme

Objekti dhe fusha e veprimit

Kjo rregullore përcakton:

- Rregullat, procedurat dhe udhëzimet që do të zbatohen për:
 - Pranimin e kandidatëve për Auditues Ligjorë në praktikën profesionale;
 - Vlerësimin e pajtueshmërisë së përgatitjes së kandidatëve me kurrikulën e miratuar dhe përcaktimin e disiplinave që duhet të mbulohen para dhe gjatë periudhës së praktikës profesionale;
 - Përgatitjen, shpalljen dhe aktualizimin e programeve të edukimit të kandidatëve për Auditues Ligjorë;
 - Kryerjen e studimeve teoriko-praktike të edukimit të kandidatëve për Auditues Ligjorë;
 - Monitorimin dhe mbikëqyrjen e kandidatëve gjatë praktikës profesionale;
 - Monitorimin dhe mbikëqyrjen e udhëheqësve të praktikës profesionale (mentorëve) të njohur nga IEKA për udhëheqjen e praktikës profesionale;
 - Organizimin e trajnimeve kualifikuese dhe trajnimeve të tjera për individë të tjerë të interesuar në disiplinat që lidhen me profesionin e Audituesit Ligjor;
 - Përgatitjen e programeve të trajnimit dhe trajnimit të grupeve specifike të lidhura me profesionin, si teknikët kontabël, kontabilistët, fiskalistët, etj.;
 - Përgatitjen e programeve të edukimit të vijueshëm profesional;
 - Përcaktimin e formave të kryerjes së kualifikimeve të vijueshme profesionale nga anëtarët;
 - Organizimin e kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve;
 - Funksionimin e strukturës së edukimit të ngjashme me një shkollë pasuniversitare që do të përfshirë edhe trajnimet për segmente të tjera të profesionit;
 - Çështje të tjera të lidhura me edukimin dhe zhvillimin profesional.

Seksioni 2

II. Komiteti i Edukimit dhe kualifikimit të vijueshëm profesional (KEKV)

2.1 Krijimi dhe funksionimi

Për të përmbushur funksionet e Këshillit Drejtues në lidhje me procedurat e hyrjes në profesion, vlerësimin e kandidatëve për Auditues Ligjorë dhe kualifikimin e vijueshëm profesional të anëtarëve, ngrihet dhe funksionon në formën e një Komiteti të Këshillit Drejtues, Komiteti i Edukimit dhe Kualifikimit të Vijueshëm (KEKV).

KEKV përbëhet nga 4 anëtarë, të cilët emërohen nga Këshilli Drejtues sipas përbërjes së mëposhtme:

- Kryetar caktohet një prej anëtarëve të Këshillit Drejtues,

- Nje anëtar zgjidhet midis anëtarëve të tjerë të Këshillit Drejtues,
- Një anëtar zgjidhet midis anëtarëve të audituesve ligjorë, të cilët e ushtrojnë profesionin,
- Një anëtar të zgjidhet nga jashtë anëtarësisë së Institutit, midis individëve të spikatur nga bota akademike apo profesionale e rregullatore.

Mandati i Kryetarit të Komitetit është i lidhur me mandatin e tij në Këshillin Drejtues. Anëtarët e Komitetit zgjidhen me një mandat 3 vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

Në marrëdhëniet me Këshillin Drejtues, me asamblenë apo për çështje të tjera specifike, KEKV përfaqësohet nga Kryetari.

Drejtori Ekzekutiv i siguron KEKV, përmes personelit ekzekutiv të Institutit, asistencën e nevojshme me punë sekretariale, organizative dhe dokumentare.

2.2 Të drejtat dhe detyrat

KEKV ka këto të drejta dhe detyra:

- (a) Përgatit propozime për Këshillin Drejtues, në lidhje me projekt programet e edukimit të kandidatëve për AL, të cilat konsultohen me strukturën e edukimit të kandidatëve për studimet praktike në nivelin postmaster. Këto programe përmbajnë trungun e disiplinave teorike bazë, që kandidatët për Auditues Ligjorë duhet të kenë studiuar gjatë edukimit universitar.
- (b) Shqyrton kërkesat e kandidatëve për të hyrë në praktikën profesionale, miraton marrëveshjet e praktikës profesionale dhe ja propozon ato për miratim Këshillit Drejtues të Institutit.
- (c) Në bashkëpunim dhe bashkërendim me strukturën e edukimit të kandidatëve mbikqyr kryerjen e praktikës profesionale nga kandidatët, monitoron udhëheqjen e kandidatëve nga ana e drejtuesve të praktikës profesionale.
- (d) I propozon Këshillit Drejtues për çështje të ndryshme të kandidatëve, sic është zgjatja e kohës së praktikës profesionale në rastin e atyre kandidatëve, për të cilët formimi vlerësohet i pamjaftueshëm, për pezullimin apo përjashtimin nga praktika profesionale në rastet e shkeljeve të përsëritura apo të rënda të rregullave.
- (e) Vlerëson ecurinë e përgatitjes së kandidatëve dhe propozon për pajisjen me certifikatën përkatëse të kandidatëve që përfundojnë me sukses praktikën profesionale.
- (f) I propozon për miratim Këshillit Drejtues projekt programet afatshkurtëra (njëvjeçare) dhe afatmesme (tre vjeçare) si edhe projekt strategjitë për zhvillimin profesional të vijueshëm të Audituesve Ligjorë.
- (g) Në bashkëpunim me drejtorin ekzekutiv, dhe në pajtim me vendimet e Këshillit Drejtues, organizon procesin e zhvillimit të vijueshëm të anëtarëve të IEKAs.
- (h) I propozon për miratim Këshillit Drejtues mënyrën dhe kriteret e monitorimit dhe të vlerësimit të procesit të zhvillimit të vijueshëm të anëtarëve, si në rastet kur kualifikimet organizohen nga IEKA ashtu edhe në rastet kur kualifikimet organizohen nga entitetet jashtë institutit.
- (i) Në pajtim me vendimet dhe politikën e Këshillit Drejtues, udhëheq procesin e testimit të anëtarëve për vlerësimin e njohurive të fituara gjatë zhvillimit të vijueshëm profesional, i cili realizohet nën përgjegjësinë e drejtorit ekzekutiv.
- (j) Vlerëson ecurinë e zhvillimit të vijueshëm profesional të anëtarëve dhe i propozon Këshillit Drejtues për masat që duhen ndërmarrë për përmirësimin e situatës, kur zhvillimi profesional i vijueshëm nuk ka qenë efektiv, si edhe për veprimet e mëtejshme që duhet të ndërmerren ndaj Audituesve Ligjorë, që nuk kanë arritur të marrin provimet lidhur me kualifikimin e vijueshëm, nuk kanë marrë pjesë në seminarët e kualifikimit të vijueshëm, apo kanë depozituar dokumente të pavërteta për kryerjen e kurseve të kualifikimit të vazhdueshëm, për rastet kur këto kurse zhvillohen nga entitetet e treta.
- (k) Jep mendime/propozime për Këshillin Drejtues për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me edukimin e kandidatëve dhe kualifikimin e zhvillimin profesional të vijueshëm të anëtarëve.

2.3 Procedurat e punës

KEKV mbledhet me thirrjen e kryetarit sa herë që është e nevojshme.

Mbledhja njoftohet të paktën 2 ditë para datës së zhvillimit dhe njoftimi përmban rendin e ditës.

KEKV mund të shqyrtojë një çështje dhe të marrë një vendim, kur në mbledhje sigurohet prania e shumicës së anëtarëve të tij.

Kur mbledhja pengohet pa arsye nga Kryetari, Këshilli Drejtues mund të caktojë njërin nga anëtarët e tjerë të tij për zhblokimin e situatës dhe vazhdimin me drejtimin e mbledhjeve.

Kur një anëtar i KEKV nuk merr pjesë pa arsye në tre mbledhje rresht, Këshilli Drejtues ka të drejtën e zëvendësimit të tij.

Mbledhjet e KEKV dokumentohen me proces verbal i cili firmoset nga kryetari dhe sekretari, i cili është pjesë e strukturës së edukimit.

Vendimet e Komitetit merren me shumicën e votave të anëtarëve dhe nënshkruhen nga të gjithë anëtarët. Në rast votash të barabarta, vota e kryetarit llogaritet dy vota. Vendimet depozitohen në selinë e Institutit dhe fotokopje të tyre u jepen të gjithë anëtarëve të komitetit, me kërkesën e këtyre të fundit.

KEKV i raporton për veprimtarinë e tij me shkrim Këshillit Drejtues dy herë në vit, respektivisht për gjashtë mujorin brenda datës 30 korrik dhe për veprimtarinë vjetore brenda datës 20 Mars të vitit pasardhës.

Seksioni 3

III. Struktura e Edukimit të Kandidatëve dhe trajnimeve (shkolla e studimeve postmaster)

3.1 Krijimi dhe funksionimi

Për të siguruar edukimin profesional të kandidatëve ngrihet dhe funksionon në formën e një strukture të vecantë të IEKAs Njësia e Edukimit të Kandidatëve për Auditues Ligjorë dhe trajnimeve profesionale, e përbërë nga jo më pak se tre punonjës.

Drejtuesi i njësisë, mbulon aspektet organizative dhe metodologjike të zhvillimit të moduleve profesionale të studimeve të avancuara profesionale. Për aspektet metodologjike drejtuesi i njësisë mund të këshillohet nga lektorët kryesorë të moduleve profesionale.

Në përbërje të strukturës së edukimit të kandidatëve dhe trajnimeve, përveç drejtuesit ka jo më pak se dy specialistë, të cilët ndjekin çështjet e edukimit të kandidatëve, kualifikimin e vijueshëm të anëtarëve, kualifikimet për të tretë, botimet dhe publikimet në median sociale, përfshirë faqen e internetit të IEKAs.

Drejtuesi i Njësies së Edukimit të Kandidatëve për Auditues Ligjorë, i cili duhet të përmbushë kriteret e kompetencës profesionale, të ketë aftësi të larta menaxheriale dhe etikë, si edhe të ketë tituj e përvojë akademike, caktohet nga Këshilli Drejtues i IEKAs.

Drejtori Ekzekutiv i IEKAs e asiston Njësinë e edukimit të Kandidatëve, përmes personelit ekzekutiv të Institutit me veprimtari sekretariale, organizative dhe dokumentare.

Veprimtaria e strukturës së edukimit mbikëqyret nga Këshilli Drejtues i IEKAs.

Këshilli drejtues harton dhe miraton rregulla të detajuara të funksionimit të shkollës dhe të realizimit të moduleve profesionale.

3.2 Veprimtaria e Strukturës së Edukimit të Kandidatëve dhe trajnimeve (studime post master)

Struktura e Edukimit të Kandidatëve dhe të trajnimit të anëtarëve kryen këto detyra:

- a) Udhëheq procesin e përgatitjes së kandidatëve për Auditues Ligjor në të gjitha modulet profesionale.
- b) I propozon për miratim Këshillit Drejtues rregulla të detajuara për mënyrën e funksionimit të shkollës së edukimit postmaster.
- c) Udhëheq nga pikëpamja metodologjike kurset e trajnimit për palë të tjera të interesuara përfshirë, kontabilistët e miratuar, kontabilistët e sektorit publik, specialistët e tatimeve, etj
- d) Propozon nëpërmjet KEKV, Këshillit Drejtues përmirësimet në programet e edukimit të kandidatëve për Auditues Ligjorë.
- a) Në bashkëpunim me KEKV dhe Drejtorin ekzekutiv realizon:
 - kualifikimet profesionale të nevojshme,
 - testimet e kandidatëve që aplikojnë për të hyrë në praktikën profesionale,
 - testimet që vlerësojnë ecurinë e formimit profesional të kandidatëve gjatë praktikës profesionale.

Seksioni 4

IV. Edukimi profesional i kandidatëve

4.1 Të përgjithshme

Praktika profesionale e kandidatëve për AL ka për qëllim të përgatisë kandidatët për të hyrë në profesionin e Audituesit Ligjor dhe siguron edukimin e tyre të mëtijshëm teorik e praktik dhe zhvillimin e aftësive, të zotësive profesionale dhe të vlerave e qëndrimeve etike.

Praktika profesionale nënkupton përfshirjen e kandidatit në veprimtari profesionale që janë ose kanë lidhje të ngushtë me auditimin ligjor të pasqyrave finaciare, individuale ose të konsoliduara.

4.2 Kushte për pranimin e kandidatëve dhe kryerjen e praktikës profesionale

Përpara se ti nënshtrohen procesit të testimeve përfundimtare për të marrë titullin AL, kandidatët duhet të kryejnë një praktikë profesionale, e cila realizohet në kushtet e një kontrate punësimi me kohë të plotë me afat 3-vjeçar të lidhur midis kandidatit dhe Audituesit Ligjor, në të cilën përcaktohet orari, kohëzgjatja e punës së kandidatit pranë drejtuesit të praktikës profesionale dhe rregullohen çështje të tjera të marrëdhënieve të punësimit në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Praktika profesionale kryhet pranë dhe nën kujdesin e një drejtuesi i cili duhet të jetë Auditues Ligjor i regjistruar në ushtrimin e profesionit për një periudhë jo më pak se prej tre vjetësh.

Një Auditues Ligjor me përvojë mbi pesë vjet mund të drejtojë deri në tre kandidatë në të njëjtën kohë, ndërsa një AL me përvojë 3-5 vjet mund të drejtojë vetëm një kandidat. Një firmë auditimi me përvojë mbi pesë vjet mund të drejtojë deri në katër kandidatë kur ka të paktën dy partnerë angazhimi (AL) me kushtin që njëri prej partnerëve të angazhimit të ketë më shumë se pesë vite në profesion.

Në rastet kur formimi i kandidatit nuk gjykohet i mjaftueshëm, KEKV ka të drejtë t'i propozojë Këshillit Drejtues zgjatjen e praktikës profesionale për kandidatin në fjalë edhe për një apo më shumë vite të tjerë.

Instituti i Ekspertëve Kontabël të regjistruar siguron që praktika profesionale të kryhet pranë personave që japin garanci të mjaftueshme për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve.

Praktika profesionale kryhet në Shqipëri. Këshilli Drejtues mund të autorizojë kryerjen e praktikës profesionale në një shtet të huaj me kusht që të jetë gjetur një drejtues i duhur dhe koha e qëndrimit jashtë të mos jetë më shumë se një e treta e kohëzgjatjes gjithsej të praktikës profesionale.

Për t'u pranuar në praktikën profesionale kandidati duhet të plotësojë këto kushte:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar,
- b) të mos jetë dënues penalisht ose me dënim plotësues, të natyrës që vë në dyshim ndershmërinë e tij;
- c) të ketë fituar një diplomë të shkollës së lartë, niveli i të cilës të jetë i barasvlershëm, të paktën me diplomën universitare të nivelit të dytë "Master" ose diplomat e barasvlershme me to, për çdonjërin nga degët e studimit në shkencat ekonomike, si kontabilitet, financë, administrim biznesi, ekonomiks apo të barasvlershme me to.

Në zbatim të pikës (c) të paragrafit të mësipërm, Këshilli Drejtues, vlerëson pajtueshmërinë e edukimit universitar të kandidatëve me kërkesat e parashikuara në kurrikulën e miratuar të profesionit të Audituesit Ligjor.

Këshilli Drejtues miraton rregullat procedurale dhe metodikën e vlerësimit të pajtueshmërisë me këto kërkesa.

Kandidatët për Auditues Ligjorë, të cilët nga Këshilli drejtues vlerësohen se nuk janë në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e kurrikulës së miratuar, duhet të plotësojnë diferencat e identifikuar para dhe gjatë periudhës së praktikës profesionale, përpara se ata të marrin pjesë në testimet për provimin përfundimtar të aftësive profesionale.

Për disa ose të gjithë disiplinat pjesë të moduleve teorike të pambuluara nga institucioni përkatës i arsimit të lartë, IEKA në bashkëpunim me një ose disa institucione të arsimit të lartë mund të organizojë mësimdhënien dhe testimet përkatëse. Ky process mund t'i delegohet institucionit të arsimit të lartë që ka siguruar me IEKAn njohjen më të madhe të moduleve teorike, me të cilin IEKA nënshkruan një memorandum bashkëpunimi ose marrëveshje.

Ndjekja e modulit profesional të avancuar në shkollën post master dhe hyrja më pas në provimin e aftësisë profesionale në çdo rast do të bëhet vetëm pasi të plotësohen kërkesat e parashikuara në programin e edukimit të miratuar të cilat lidhen me lëndën/disiplinat përkatëse që kërkohen në nivelet bazë dhe të ndërmjetëm.

4.3 Përgjashtimi i kandidatëve nga detyrimi për kryerjen e praktikës profesionale

Përgjashtohen vetëm nga detyrimi për të kryer praktikën profesionale, individët që, për pesëmbëdhjetëvjet, kanë qenë të angazhuar në veprimtari profesionale, të cilat u kanë dhënë mundësi të fitojnë përvojën e mjaftueshme në fushën e kontabilitetit, auditimit, finances dhe legjislacionit. Vendimi për përgjashtimin nga detyrimi i kryerjes së praktikës profesionale merret rast pas rasti nga Këshilli Drejtuesi i IEKAs, pas propozimit të strukturës së edukimit dhe KEKV. Vendimi i dërgohet për miratim BMP-se

Gjithashtu përgjashtohen nga detyrimi për kryerjen e praktikës profesionale shtetasit shqiptarë, të cilët kanë fituar titullin CPA apo ACCA në një shtet tjetër dhe që janë anëtarë të një organizmi profesional të Audituesve Ligjorë në një shtet tjetër. Këta individë i nënshtrohen të njëjtit process testimi, të cilit i nënshtrohen edhe kandidatët.

Përgjashtohen nga kryerja e praktikës profesionale dhe detyrohen të kryejnë vetëm testimet, në kuadrin e provimit përfundimtar të aftësive profesionale, në disiplinat e legjislacionit fiskal, të shoqërive tregtare, sigurimeve shoqërore, të drejtën e punës dhe të drejtën civile, në masën që këto i interesojnë auditimit ligjor, shtetasit shqiptarë dhe të huaj që kanë fituar titullin "Auditues Ligjor"

apo ekuivalentin e tij dhe **janë të regjistruar për të ushtruar veprimtarinë si anëtarë** të një organizate profesionale të audituesve ligjorë në një shtet tjetër, kur program i përgatitjes së tyre vlerësohet nga IEKA se është në pajtueshmëri, në masën jo më pak se 75 përqind, me programin e përgatitjes së Audituesve Ligjorë në Shqipëri.

Për të vlerësuar pajtueshmërinë me kërkesat e përjashtimit nga praktika profesionale dhe/ose nga disa prej provimeve përfundimtare, KD i IEKAs harton dhe miraton rregulla proceduriale të detajuara.

4.4 Dokumentacioni që duhet të paraqitet për të përfituar përjashtimin nga kryerja e praktikës profesionale

(a) Individët me përvojë mbi 15 vjet në veprimtari profesionale

Individët që aplikojnë për të përfituar përjashtimin nga detyrimi i kryerjes së praktikës profesionale duhet të paraqesin në IEKA dokumentet e mëposhtëme:

- Kërkesë me shkrim, ku të argumentohet se plotësohen kërkesat e parashikuara nga ligji;
- Kopjen e diplomës së shkollës së lartë, sipas kërkesave të ligjit 10091 dhe listën e notave të noterizuar;
- Vërtetim mbi gjëndjen gjyqësore;
- Kopjen e kartës së identitetit ose të pasaportës për jashtë shtetit;
- Curriculum vitae të aktualizuar që fillon nga periudha më e fundit dhe shkon në periudhën më të hershme;
- Kopjen e librezës së punës, shoqëruar me vërtetime në formën e referencave zyrtare të lëshuara nga punëdhënësit përkatës, ku jepen detaje mbi llojin e punëve të kryera;
- Kopje të certifikuara të kualifikimeve të ndjekura apo të veprimtarive përkatëse profesionale ku individ është përfshirë;
- Çdo dokument tjetër që gjykohet nga komiteti se provon përmbushjen e kërkesave të ligjit.

(b) Shtetasit shqiptarë mbajtës të titullit CPA dhe ACCA

Për t'u përjashtuar nga praktika profesionale këta shtetas duhet të paraqesin në Institut dokumentet e mëposhtëme:

- Kërkesë me shkrim, ku të parashtrohet kërkesa për përjashtim nga kryerja e praktikës profesionale;
- Kopjen e kartës së identitetit ose të pasaportës për jashtë shtetit;
- Curriculum vitae të aktualizuar;
- Kopje të certifikuar (me apostille) të titullit ACCA ose CPA të marrë një shtet tjetër, të shoqëruar me programin aftësisë profesionale për të cilin është testuar;
- Vërtetim të certifikuar (me apostille) që tregon për gjëndjen e anëtarësisë në organizmin e huaj të audituesve ligjorë;
- Çdo dokument tjetër që gjykohet nga Komiteti se provon përmbushjen e kërkesave të ligjit.

(c) Audituesit ligjor të huaj

Shtetasit e huaj që janë auditues dhe kërkojnë të regjistrohen në regjistrin publik të audituesve ligjorë, duhet t'i drejtojnë një kërkesë me shkrim Këshillit Drejtues për të vlerësuar shkallën e pajtueshmërisë së programit të përgatitjes së Audituesit Ligjor të huaj me programin e Audituesve Ligjorë vendas.

Për këtë qëllim këta shtetas duhet të paraqesin në Institut dokumentet e mëposhtëme:

- Kërkesë me shkrim, ku të parashtrahet kërkesa për t'u regjistruar ne regjistrin publik të IEKAs;
- Kopjen e kartës së identitetit ose të pasaportës për jashtë shtetit;
- Curriculum vitae të aktualizuar që fillon nga periudha më e fundit dhe shkon në periudhën më të hershme;
- Kopje të certifikuar (me apostille) të titullit Auditues ligjor të marrë një shtet tjetër, të shoqëruar me programin aftësisë profesionale për të cilin është testuar;
- Vërtetim të certifikuar (me apostille) që tregon për regjistrimin në regjistrin publik të Organizmit të huaj të audituesve ligjorë të regjistruar;
- Çdo dokument tjetër që gjykohet nga Komiteti se provon përmbushjen e kërkesave të ligjit.

4.5 Shqyrtimi dhe vlerësimi i aplikimeve.

Aplikimet për përjashtimin nga praktika profesionale shqyrtohen nga KEKV, i cili bashkërendon punën me strukturën e edukimit për shkollën post master.

KEKV gjatë shqyrtimit të kërkesave për aplikimet sipas rastit, mund të kërkoj informacione shtesë për t'u bindur për vërtetësinë e dokumentacionit të sjellë.

Në përfundim të shqyrtimit, vlerëson pajtueshmërinë e tyre me kriteret e dhëna dhe i paraqet Këshillit Drejtues një relacion ku shprehet opinioni në lidhje me kërkesën e bërë.

Komiteti shqyrton edhe kërkesat sëbashku me dokumentacionin e paraqitur nga shtetasit shqiptarë apo që kanë fituar titullin CPA apo ACCA në një shtet tjetër, bën verifikimin e saktësisë, vlerësimin e tyre si edhe kushtin e anëtarësisë në një organizatë dhe i raporton me shkrim Këshillit Drejtues.

KEKV shqyrton edhe kërkesat sëbashku me dokumentacionin e paraqitur nga shtetasit e huaj, bën verifikimin e saktësisë, vlerësimin e tyre dhe i raporton me shkrim Këshillit Drejtues.

Këshilli Drejtues harton rregulla të detajuara për vlerësimin dhe njohjen e disa prej testeve të moduleve profesionale përfundimtare për shtetasit shqiptarë mbajtes të titujve CPA dhe ACCA. Këto rregulla mund të parashikojnë detyrimin për një praktikë profesionale të monitoruar.

Seksioni 5.

V. Praktika profesionale e kandidatëve për AL

5.1 Procedurat e hyrjes në praktikën profesionale

Kërkesat për të marrë pjesë në programin e praktikës profesionale bëhen në periudhën 1- 15 nëntor të çdo viti. Ato dërgohen në rrugë postare ose depozitohen dorazi në Institut. Kërkesa do të jetë e shoqëruar nga dokumentet që justifikojnë përmbushjen e kërkesave të ligjit 10091 i ndryshuar dhe të kësaj rregulloreje, si dhe të ketë të bashkëlidhur marrëveshjen e kryerjes së praktikës profesionale të nënshkruar nga të dy palët. Këshilli Drejtues përcakton dhe publikon llojet e dokumentave që do të paraqiten si dhe modelin tip të marrëveshjes.

Kërkesat për hyrje në praktiken profesionale shqyrtohen nga KEKV, në bashkëpunim me Drejtorin Ekzekutiv gjatë muajit Dhjetor të cdo viti, bazuar në dokumentacionin e paraqitur KEKV i paraqet për miratim Këshillit Drejtues brenda datës 30 Dhjetor listën e kandidatëve që propozohen për t'u pranuar në praktikën profesionale si edhe listën e të refuzuarve me argumentet përkatëse.

Këshilli Drejtues merr vendim brenda muajit dhjetor të çdo viti. Lista e kandidatëve të pranuar në praktikën profesionale publikohet në faqen e internetit të IEKA-s. Kandidatëve të cilëve ju refuzohet

nga Këshilli i Drejtimit kërkesa për tu pranuar në praktikën profesionale ju kthehet përgjigje me shkrim duke i dhënë edhe arsyet e refuzimit.

Kandidatët e pranuar në praktikën profesionale detyrohen të paguajnë një kuotë profesionale, që miratohet çdo vit nga Këshilli Drejtues. Kjo kuotë është e pa kthyeshme.

5.2 Marrëveshja e praktikës profesionale

Përpara se të fillojë praktikën profesionale, kandidati duhet të nënshkruajë një marrëveshje me udhëheqësin e tij.

Marrëveshja e praktikës profesionale hartohet në tre kopje dhe i bashkëlidhet kërkesës për hyrje në një praktikë profesionale. Pasi miratohet nga KEKV një kopje i kthehet drejtuesit të praktikës profesionale dhe një kopje i jepet kandidatit. Kopja e tretë, bashkë me kërkesën dhe dokumentet e tjerë për pranimin në praktikën profesionale ruhen në selinë e Institutit.

Në qoftëse marrëveshja është nënshkruar në emër të një shoqërie audituesish ligjore, kjo e fundit duhet të caktojë një Auditues Ligjor, përgjegjës për drejtimin e praktikës profesionale.

Marrëveshja e praktikës profesionale përmban:

- Detyrat e palëve të përcaktuara në përshtatje me kërkesat e rregullave për organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor, në këtë rregullore dhe udhëzimet e dhëna nga Instituti.
- Detyrat e drejtuesit të praktikës profesionale, i cili siguron formimin profesional të kandidatit përmes përfshirjes së këtij të fundit në veprimtaritë e auditimit dhe të rishikimit, të cilat bëjnë të mundur fitimin e përvojës profesionale të nevojshme.
- Detyrat e kandidatit, vecanërisht ato për respektimin e ligjshmërisë, mospjesëmarrjen e interesave të drejtuesit të praktikës profesionale gjatë kryerjes së praktikës profesionale dhe për përkushtimin në punë e mbajtjen e lidhjeve me drejtuesin.

Marrëveshja e praktikës profesionale mund të përfshijë edhe një periudhë prove e cila mund të jetë nga 3 muaj deri 6 muaj. Gjatë kësaj periudhe të dy palët mund ta prishin marrëveshjen e praktikës profesionale duke paralajmëruar për këtë një muaj para datës së prishjes së marrëveshjes. Pala që paralajmëron prishjen e marrëveshjes njofton paraprakisht KEKV. Pas mbarimit të periudhës së provës marrëveshja e praktikës profesionale mund të zgjidhet me pëlqimin e të dy palëve ose për një arsye të ligjshme e cilësuar e tillë nga KEKV.

5.3 Zhvillimi i praktikës profesionale

Fillimi i praktikës profesionale përkon me fillimin e vitit kalendarik. Kandidatët e pranuar i nënshtrohen një testimi i cili shërben për të testuar njohuritë e formimit të përgjithshëm, njohuritë bazë në fushën e kontabilitetit e financës dhe aftësitë e komunikimit me shkrim dhe nëse gjykohet edhe me gojë. Ky testim organizohet brenda muajve janar-shkurt të vitit të parë të praktikës profesionale. Testimi organizohet vetëm njëherë. Mospjesëmarrja në testim është automatikisht skualifikuese. Testimi është eliminues. Fitues shpallet kandidati që fiton të paktën 50 pikë. Kandidati jo fitues nuk vijon praktikën profesionale. Ai mund ta rifillojë përsëri praktikën profesionale në vitin e ardhshëm.

Gjatë kryerjes së praktikës profesionale kandidatët duhet të përmbushin detyrimet e saj dhe të bëjnë përpjekje e të thellojnë njohuritë profesionale, të jenë të bindur e të denjë për profesionin dhe t'i nënshtrohen çdo kontrolli të veprimtarisë së tyre nga ana e Institutit.

Praktika profesionale përfshin të paktën 800 orë punë në vit në auditimin ligjor të pasqyrave financiare. Orët e punës do të kryhen pranë dhe për llogari të drejtuesit të praktikës profesionale, sipas një kalendarit që hartohet çdo vit. Orët e punës të AL në auditimin ligjor të pasqyrave financiare

të llogariten me koeficientin 1.5 për efekt të llogaritjes së orëve të auditimit të kandidatëve në praktikën profesionale.

Këshilli Drejtues mund të autorizojë që orët e punës të praktikës profesionale të kryhen pranë dhe për llogari të më shumë se një audituesi ligjor apo shoqërie të audituesve ligjorë, por ky numër nuk mund të jetë më shumë se tre, përfshirë edhe drejtuesin. Kandidati në praktikën profesionale duhet të bëjë të paktën 70% të orëve të punës tek drejtuesi i praktikës profesionale. Një pjesë e orëve të praktikës profesionale, sipas vlerësimit të drejtuesit të praktikës profesionale, mund të kryhet edhe pranë punëdhënësve të tjerë por në poste pune që janë të natyrës kontabël dhe financiare dhe që i shërbejnë formimit profesional të kandidatit.

Në çdo rast drejtuesi i praktikës profesionale dhe i kandidatit do të jetë vetëm Audituesi Ligjor i rregjistruar që ka marrë përsipër këtë rol.

Kandidati duhet të përmbushë me kujdes misionet e punëve që i ngarkohen nga drejtuesi i praktikës profesionale dhe të ndjekë udhëzimet e dhëna prej tij.

Në çdo rast të ndryshimit të drejtuesit të praktikës profesionale nga kandidati apo largimit të kandidatit nga udhëheqësi i praktikës profesionale, secila palë duhet ti dërgojë një kërkesë me arsyetimet përkatëse Drejtorit Ekzekutiv të Institutit.*

Kandidati në praktikën profesionale duhet të respektojë dispozitat ligjore dhe rregullat që lidhen me punën, mungesat në punë dhe pushimet sipas përcaktimeve në Kodin e Punës të RSH.

Për kandidatët në praktikën profesionale që nuk respektojnë rregulloren e Edukimit dhe Kualifikimit Profesional dhe vendimet e KD, merren masa disiplinore deri në përjashtimin nga kryerja e praktikës profesionale. Edhe për udhëheqësit e praktikës profesionale të cilët nuk respektojnë kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore në lidhje me marrëdhënien e tyre me kandidatët në praktikën profesionale merren masa disiplinore. Në të dyja rastet me sipër, Këshilli Drejtues vendos për masën disiplinore.

Kandidati mban një ditar të praktikës profesionale në të cilin evidenton punët që ka kryer ose punët në të cilat ka marrë pjesë, duke shënuar emërtimin dhe formën juridike të sipërmarrjes, natyrën e veprimtarisë së saj, karakterin e misionit dhe kohën e punës të realizuar nga kandidati në kryerjen e misionit, e të tjera të dhëna të nevojshme. Ditari mbahet duke ruajtur fshehtësinë (sekretin) profesionale.

Gjatë periudhës së praktikës profesionale, kandidati është i detyruar të ndjekë programet e edukimit postmaster në të pesë modulet profesionale. Ai duhet të përmbushë të gjitha detyrimet e parashikuara në rregulloren e funksionimit të shkollës së detyrimeve postmaster.

Kandidati, gjatë kryerjes së praktikës profesionale është i detyruar të zbatojë kërkesat e legjislationit në fuqi, vendimet e Asamblesë dhe të Këshillit Drejtues të Institutit si dhe të KEKV. Ai respekton rregullat dhe kërkesat e parashikuara në Kodin e Etikës për Audituesit Ligjorë, dhe në rast të shkeljes së tyre, mund të ndëshkohet deri në përjashtim nga praktika profesionale.

Drejtuesi i praktikës profesionale të kandidatit, duke qënë përgjegjësi kryesor për formimin e kandidatit, duhet t'i mundësojë kandidatit kryerjen e praktikës profesionale në kushte optimale dhe mund t'i ngarkojë edhe kryerjen e punëve profesionale nën udhëzimin dhe mbikëqyrjen e tij.

Drejtuesi i praktikës profesionale të kandidatit kontrollon mbajtjen e ditarit nga kandidati dhe shënon atje të gjitha rezultatet kryesore të vëzhgimeve të tij. Ai njihet rregullisht me raportimet e kandidatit. Drejtuesi dhe kandidati nënshkruajnë ditarin e praktikës profesionale pasi kanë diskutuar vërejtjet e bëra nga drejtuesi.

Kandidatët janë të detyruar që të regjistrojnë të gjitha punët e kryera në një ditar të praktikës profesionale, i cili mbahet në dy kopje dhe dorëzohet vetëm një herë në vit, jo më vonë se data 10 janar. Njëra nga kopjet dorëzohet në Institut së bashku me raportin dhe vlerësimin e bërë nga Audituesi Ligjor, i cili është drejtuesi i praktikës profesionale për kandidatin. Në rast të mosdorëzimit brenda afatit, KEKV jep vërejtje dhe vendos një afat të dytë paralajmërues për depozitimin, jo më vonë se data 25 Janar. Nëse shkelet edhe afati i dytë, pavarësisht arsyes kandidati përsërit vitin e praktikës profesionale dhe mund ta dorëzojë ditarin vetëm vitin e ardhshëm.

Audituesi Ligjor apo shoqëria audituese, që ka nënshkruar kontratë me kandidatin, i raporton Institutit vlerësimin e tij çdo gjashtë muaj për ecurinë e këtij të fundit dhe për përfundimin e praktikës profesionale. Raportimi bëhet brenda datës 10 të muajit pasardhës.

Gjatë periudhës së praktikës profesionale, kandidati është i detyruar të ndjekë leksionet dhe seminarët sipas moduleve profesionale të organizuara nga Njesia e Edukimit të kandidatëve për Auditues Ligjorë dhe trajnimeve dhe t'i nënshtrohet testeve të ndërmjetme dhe përfundimtare, sipas parashikimeve në rregullat e detajuara të funksionimit të strukturës së edukimit dhe të realizimit të moduleve profesionale, të miratuara nga Këshilli Drejtues.

Në periudhën shtator – nëntor të vitit të përfundimit të praktikës profesionale, kandidatët të cilët kanë kaluar me sukses testet në modulet profesionale do të depozitojnë dhe mbrojnë një punim profesional që përfshin trajtime teorike e praktike në çështje me interes për profesionin, sipas parashikimeve në rregullat e detajuara të funksionimit të strukturës së edukimit të kandidateve dhe të realizimit të moduleve profesionale, të miratuara nga Këshilli Drejtues.

Praktika profesionale merr fund:

- me lëshimin e certifikatës së mbarimit të praktikës profesionale,
- kur kandidati tërhiqet nga praktika profesionale,
- kur kandidati përjashtohet nga praktika profesionale,
- Kur kandidati nuk kalon testin e të njëjtit vit të praktikës profesionale për dy vjet rresht,
- Kur ndërprerja ose ndërprerjet janë në total më shumë se dy vjet.

Seksioni 6

6. Zhvillimi profesional dhe kualifikimi i vijueshëm i anëtarëve

Për të garantuar mbrojtjen e interesit publik, të gjithë Audituesit Ligjorë që ushtrojnë dhe nuk ushtrojnë profesionin duhet të demonstrojnë në çdo rast aftësi profesionale, kompetencë dhe qëndrime e vlera etike të larta. Për këtë qëllim Audituesit Ligjorë, duhet të plotësojnë detyrimin e kualifikimit profesional të vijueshëm në pajtim me programet e shpallura nga Këshilli Drejtues, përmes pjesëmarrjes në seminarët e kualifikimit të vijueshëm.

Kohëzgjatja e seminareve të kualifikimit të vijueshëm të detyrueshëm, e cila nuk mund të jetë më pak se 40 orë në vit, propozohet nga KEKV dhe miratohet çdo vit nga Këshilli Drejtues.

Programet e kualifikimit të vijueshëm profesional, miratohen nga Këshilli Drejtues i IEKAs brenda datës 28 Mars të çdo viti. Këto programe së bashku me kalendarin kohor të zhvillimit të kualifikimeve që organizohen nga vetë instituti, publikohen në faqen e internetit të IEKAs brenda muajit Prill dhe ju njoftohen të gjithë anëtarëve.

Në përcaktimin e programit të zhvillimit profesional të vijueshëm mbahen parasysh kërkesat e anëtarëve të veçantë apo grupeve të anëtarëve, si edhe zhvillimet kombëtare e ndërkombëtare të cilat ndikojnë në profesionin e Audituesit Ligjor.

Zhvillimi i vijueshëm profesional është i detyrueshëm të kryhet edhe nga Audituesit Ligjorë të cilët nuk e ushtrojnë profesionin. Përpara se të përfshihen në Regjistrin Publik këta individë duhet të kenë përmbushur kërkesat e kualifikimit të vijueshëm. Në rastet kur nuk kanë marrë pjesë në kualifikimin e vijueshëm profesional, ata duhet të testohen për njohuritë sipas sesioneve të munguara përpara se të përfshihen në regjistrin publik.

Audituesit Ligjorë që do të kryejnë kualifikimin e vijueshëm tek institucionet e tjera të njohura, duhet të njoftojnë me shkrim Institutin jo më vonë se dy javë para fillimit të kursit duke dhënë detaje të mjaftueshme për Institucionin, lektorët që do të zhvillojnë seminarët, vendin dhe kalendarin e zhvillimit të kurseve sipas referimit në nenin 6 të kësaj rregulloreje. (Aneks 1)

Në rastet ku AL kanë munguar më shumë se 20% të kohës së parashikuar (40 orë në vit), ose në rastet kur nuk kanë rezultuar fitues në testimin e kryer në përfundim të kualifikimit, Këshilli Drejtues i organizatës profesionale krijon një komitet ad hoc nën drejtimin e Kryetarit të Këshillit, për të organizuar testimin e njohurive për sesionet e kualifikimeve.

Komiteti ad hoc mblidhet deri në një periudhë 1-mujore nga bërja e kërkesës së Audituesit Ligjor që kërkon të regjistrohet në Regjistrin Publik në rastet kur nuk është përmbushur kushti i kualifikimit të vijueshëm. Ky komitet, brenda muajit dhjetor organizon testimin për audituesit që kanë munguar në kualifikimin e vijueshëm ose që nuk kanë rezultuar fitues nga testimi.

Kostot e zhvillimit të vijueshëm profesional si dhe kostot e ritestimit përballohen nga Audituesit Ligjorë. Ato llogariten nga personeli ekzekutiv dhe miratohen nga Këshilli Drejtues.

Përveç organizimit nga Instituti, kurset për kualifikimin e vijueshëm profesional mund të organizohen edhe nga institucione të arsimit të lartë; qendra të tjera të kualifikimit profesional, të cilat kanë mjediset dhe personelin e duhur për garantimin e një kualifikimi cilësor, në përputhje me programet e miratuara për kualifikimin e vazhdueshëm profesional si edhe, nga shoqëritë e auditimit, të cilat kanë kapacitetet e duhura për të organizuar kualifikimin për të punësuarit e tyre.

Për t'u njohur nga Këshilli Drejtues kualifikimin e vijueshëm të organizuar nga palët e treta, ato duhet të garantojnë se kanë kapacitetet e duhura si përsa i përket mjedisëve edhe personelit, për garantimin e një kualifikimi cilësor në përputhje me programet e miratuara për kualifikimin e vazhdueshëm profesional.

Gjithashtu, Këshilli Drejtues miraton formate specifike të njohjes dhe konvertimit në orë të kualifikimit të vijueshëm, të disa veprimtarive të tilla sic janë:

- Pjesëmarrja e AL në Konferencat Profesionale Kombëtare ose Ndërkombëtare që lidhen me profesionin;
- Botimi i artikujve teknike dhe profesionale brenda dhe jashtë vendit;
- Pjesëmarrja në kualifikimin e vijueshëm profesional të organizuara nga institucione të arsimit të lartë; qendra të tjera të kualifikimit profesional si dhe shoqëri audituese për të punësuarit e vet, të cilat janë njohur më parë nga Këshilli Drejtues i organizatës profesionale.

Palët e treta që dëshirojnë të përfshihen në realizimin e programeve të zhvillimit profesional të Audituesve Ligjorë, janë të detyruar të komunikojnë dhe të rakordojnë paraprakisht programin me Institutin dhe më pas të vënë në dijeni Bordin e Mbikëqyrjes Publike.

Ata koepërojnë e koordinojnë me Këshillin Drejtues të Institutit, në lidhje me mundësitë që kanë apo për informacione të mëtejshme që ata mund të kërkojnë, për të realizuar një pjesë apo të gjitha programet e edukimit të shpallura nga instituti.

Personeli ekzekutiv dhe struktura edukimit të kandidatëve kanë të drejtë të kryejnë monitorimin e kurseve të kualifikimit të vijueshëm të organizuar nga palët e treta. Për çdo monitorim të kryer përgatitet një raport për KEKV dhe KD.

Audituesit Ligjorë të cilët kanë kryer kualifikimin profesional në institucionet e përmendura më sipër, duhet të dorëzojnë në IEKA vërtetimin e plotësimit të kualifikimit të vijueshëm si dhe vlerësimin përkatës kur kjo është e përshtatshme. Vërtetimi dorëzohet jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të kualifikimit.

Mospërmbushja nga Audituesit Ligjorë, e kërkesave të zhvillimit profesional të vijueshëm të detyrueshëm, dështimet në testimin e njohurive të marra nga kualifikimi i vijueshëm, apo depozitimi i dokumenteve të pavërteta për kryerjen e kurseve të kualifikimit të vazhdueshëm nga të tretët, mund të cojnë në pezullimin e ushtrimit të profesionit nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike dhe ç'regjistrimin e Audituesve Ligjorë nga Regjistri Publik.

Në përfundim të çdo kursi kualifikimi të vijueshëm, Audituesi Ligjor pajiset me vërtetimin e plotësimit të detyrimit, si dhe me vlerësimin përkatës kur kjo është e përshtatshme.

Audituesit Ligjorë do të registrohen për kryerjen e kurseve të kualifikimit, kur këto realizohen nga Instituti jo më vonë se dy javë para datës së fillimit të programit, ndërsa në rastet kur ata vendosin ta kryejnë kualifikimin tek institucionet e tjera të njohura, ata janë të detyruar të njoftojnë me shkrim Institutin jo më vonë se dy javë para fillimit të kursit duke dhënë detaje të mjaftueshme për Institucionin, lektorët që do të zhvillojnë seminarët, vendin dhe kalendarin e zhvillimit të kurseve. Vërtetimi që marrin nga organizatorët e trajnimeve depozitohet në Institut 30 ditë pas përfundimit të trajnimit.

Seksioni 7

VII. Hyrja në fuqi

Autorizohet Këshilli Drejtues i Institutit të bëjë plotësime e ndryshime në këtë Rregullore, të cilat i paraqiten për ratifikim Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve në mbledhjen e ardhëshme. Plotësimet dhe ndryshimet bëhen të zbatueshme që nga data e shpalljes së tyre nga Këshilli Drejtues.

Këshilli Drejtues autorizohet të procedojë me ngritjen e KEKV dhe Strukturës së studimeve postmaster.

Kjo rregullore, u miratua nga Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarëve me vendimin Nr 134 datë, 28.06.2018.